

“Krijimi i hapsirës evropiane të arsimit të lartë”

Komunikatë e Konferencës së ministrave
përgjegjës për arsimin e lartë

Berlin, 19 shtator 2003

Hyrje

Më 19 qershor 1999, një vit pas Deklaratës së Sorbonës, ministrat përgjegjës për arsimin e lartë nga 29 shtete të Evropës e nënshkruan Deklaratën e Bolonjës. Ata u pajtuan për objektivat e përbashkëta që janë të rëndësishme për zhvillimin e një hapsire evropiane të arsimit të lartë, të ndërlidhur dhe të unifikuar deri në vitin 2010. Menjëherë pas kësaj, në konferencën e mbajtur në Pragë në 19 maj të vitit 2001, u shtua numri i objektivave dhe u ripohua përkushtimi dhe përgjegjësia për ta krijuar hapsirën evropiane të arsimit të lartë deri në vitin 2010. Në 19 shtator të vitit 2003, ministrat përgjegjës për arsimin e lartë nga 33 shtete evropiane u takuan në Berlin që të shqyrtojnë arritjet dhe të përcaktojnë prioritetet dhe objektivat e reja për vitet që vijnë, duke e pasur parasysh përshtetimin e realizimit të hapsirës evropiane të arsimit të lartë. Ata u pajtuan për këto çështje, parime dhe prioritete:

Ministrat e ripohojnë rëndësinë e tipareve shoqërore të procesit të Bolonjës. Duhet gjetur drejtpeshimi mes nxitjes së konkurrencës dhe synimit për përmirsimin e karakteristikave shoqërore të hapsirës evropiane të arsimit të lartë, duke pasur parasysh përfundimin e kohezionit shoqëror dhe zbutjen e pabarazisë sociale dhe gjinore, si në nivel kombëtar, ashtu dhe në nivel evropian. Në këtë kontekst, ministrat e ripohojnë qëndrimin e tyre se arsimi është një dobi publike dhe përgjegjësi publike. Ata theksojnë se gjatë bashkëpunimit dhe shkëmbimit akademik, duhet të dalin në pah vlerat akademike.

Ministrat i kanë parasysh konkluzionet e Këshillit Evropian në Lisbonë (2000) dhe në Barcelonë (2002) që kanë për qëllim ta shndërrojnë Evropën në “ekonominë më garuese dhe dinamike në botë, të mbështetur në njohuri, dhe të aftë për të siguruar zhvillim afatgjatë ekonomik me më shumë punësim dhe me kohezion më të madh shoqëror” dhe përpiqen për veprime të mëtejme dhe bashkëpunim më të thellë në kontekst të procesit të Bolonjës.

Ministrat e kanë parasysh raportin e ecurisë të përpiluar për Grupin mbështetës për zhvillimin e procesit të Bolonjës gjatë periudhës mes Pragës dhe Berlinit. Ata poashtu e kanë parasysh raportin për zhvillim-III të përgatitur nga Shoqata e universiteteve evropiane (EUA), ashtu si dhe rezultatet e seminareve që janë organizuar si pjesë e programit në kohën nga Praga në Berlin nëpër disa shtete anëtare dhe nëpër institucione të arsimit të lartë, në organizata dhe tek studentët. Ministrat më tej i shqyrtojnë raportet kombëtare, të cilat e dëshmojnë përparimin domethënës gjatë zbatimit të parimeve të procesit të Bolonjës. Së fundi, ata i kanë parasysh edhe porositë e Komisionit Evropian dhe Këshillit Evropian dhe shprehin mirënjohje për përkrahjen e tyre gjatë zbatimit të këtij procesi.

Ministrat pajtohen se do të bëhen përpjekje për të siguruar ndërlidhjen mes institucioneve të arsimit të lartë dhe sistemeve të hulumtimit në vendet përkatëse. Kjo hapsirë që krijohet në arsimin e lartë evropian do të përfitojë nga bashkërendimi me hapsirën evropiane të hulumtimit, duke i përforcuar bazat evropiane të njohurisë. E gjithë kjo ka për qëllim ta ruajë pasurinë kulturore dhe shumëllojshmërinë gjuhësore të Evropës, të rrënjoshur në trashëgiminë e pasur, dhe poashtu ka për qëllim ta nxisë potencialin inovativ dhe zhvillimin shoqëror e ekonomik nëpërmjet bashkëpunimit mes institucioneve të arsimit të lartë në Evropë.

Ministrat e vlerësojnë rolin thelbësor të institucioneve të arsimit të lartë dhe të organizatave studentore për krijimin e hapsirës evropiane të arsimit të lartë. Ata e kanë parasysh porosinë e Shoqatës të universiteteve evropiane (EUA) nga Konventa e Gracit për institucionet e arsimit të lartë, kontributet e Shoqatës evropiane të institucioneve të arsimit të lartë (EURASHE) dhe komunikatat nga ESIB – Unionet kombëtare të studentëve në Evropë.

Ministrat e mirëpresin interesimin e regjioneve të tjera në botë për zhvillimin e hapsirës evropiane të arsimit të lartë, dhe poashtu e mirëpresin praninë e përfaqësuesve të vendeve të tjera evropiane që ende nuk marrin pjesë në procesin e Bolonjës, Komitetin mbështetës të Bashkësisë Evropiane, si dhe Hapsirën e përbashkët e arsimit të lartë në Amerikën Latine dhe Karraibet (EULAC) si musafirë në këtë konferencë.

Përparimi

Ministrat i mirëpresin iniciativat e ndërmarra që nga Konferenca për arsimin e lartë në Pragë, për të ecur drejt krahasueshmërisë dhe konkurrencës më të madhe, ashtuqë sistemet e arsimit të lartë të jenë më transparente dhe cilësia e arsimit të lartë evropian të forcohet në nivele institucionale dhe kombëtare. Ata e vlerësojnë bashkëpunimin dhe përkushtimin e të gjithë partnerëve – institucioneve të arsimit të lartë, studentëve, dhe përfituesve të tjerë – drejt këtij qëllimi.

Ministrat e theksojnë rëndësinë e të gjithë elementeve të procesit të Bolonjës për krijimin e hapsirës evropiane të arsimit të lartë si dhe nevojën për përforsimin e përpjekjeve në nivel institucional, kombëtar, dhe evropian. Poashtu, për t'i dhënë këtij procesi më shumë shtytje, ata përcaktohen për prioritetet më urgjente për dy vitet që vijnë. Ata do të përpiqen për promovimin e sistemeve të efektshme të sigurimit të cilësisë, për përdorimin efikas të sistemit të bazuar në dy cikle dhe për njohjen e titujve dhe periudhave të studimit.

Sigurimi i cilësisë

Cilësia e arsimit të lartë është dëshmuar si thelbësore për krijimin e një hapsire evropiane të arsimit të lartë. Ministrat zotohen të përkrahin zhvillimin e mëtejshëm të sigurimit të cilësisë në nivel institucional, kombëtar dhe evropian. Ata e theksojnë nevojën për zhvillimin e kriterëve dhe metodologjive të përbashkëta për sigurinë e cilësisë.

Ata poashtu e theksojnë se në përputhje me parimin e autonomisë institucionale, përgjegjësia parësore për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë ngel tek vetë institucionet, gjë që mundëson përgjegjshmërinë e vërtetë të sistemit akademik brenda kornizave të cilësisë në një vend.

Prandaj, ata u pajtuan që deri në vitin 2005, sistemet kombëtare të sigurimit të cilësisë do të duhej të përmbajnë:

- Përcaktimin e përgjegjësive të organizmave dhe institucioneve të përfshira.
- Vlerësimin e programeve apo institucioneve, duke përfshirë vlerësimin e brendshëm, vlerësimin e jashtëm, pjesëmarrjen e studentëve dhe botimin e rezultateve.
- Sistemin e akreditimit, certifikimit apo të procedurave të tjera të ngjashme.
- Pjesëmarrjen ndërkombëtare, bashkëpunimin dhe rrjetimin.

Në nivel evropian, ministrat e ftojnë ENQA-n dhe anëtarët e saj, në bashkëpunim me EUA-n, EURASHE-n dhe ESIB-in, që të përpilojnë një grup standardesh me marrëveshje, procedura dhe udhëzime për sigurimin e cilësisë, të hulumtojnë mënyra për sigurimin e një sistemi të përshtatshëm të vlerësimit nga kolegët për agjencitë apo organizatat e sigurimit të cilësisë dhe/apo akreditimit, dhe pastaj t'u raportojnë të ministrave nëpërmjet Grupit mbështetës në takimin e ardhshëm në vitin 2005. Do të merren parasysh ekspertët dhe shoqatat e tjera të sigurimit të cilësisë si dhe rrjeti përkatës.

Struktura e titujve: Pranimi i një sistemi që kryesisht mbështetet në dy cikle

Ministrat kanë kënaqësinë të konstatojnë se, në përputhje me sistemin dy-fazësh të Deklaratës së Bolonjës, po shkohet kah një ristrukturim i hapsirës evropiane të arsimit të lartë. Të gjithë ministrat zotohen ta fillojnë zbatimin e këtij sistemi të dy cikleve deri në vitin 2005.

Ministrat e theksojnë rëndësinë e arritjeve të deritashme, dhe të përpjekjeve për të kuptuar dhe pranuar diplomat e titujt e rinj, duke e përkrahur dialogun brenda institucioneve ashtu si dhe mes institucioneve dhe punëdhënësve.

Ministrat i nxisin dhe përkrahin shtetet anëtare që të përpilojnë një kornizë të kualifikimeve të krahasueshme dhe të pajtueshme në sistemet e tyre të arsimit të lartë, ashtuqë këto kualifikime të mund të përshkruhen sipas sasisë së ngarkesës së punës, nivelit dhe rezultateve të të nxënit, aftësive dhe profilit. Ata poashtu zotohen që të prodhojnë një kornizë gjithëpërfshirëse të kualifikimeve për hapsirën evropiane të arsimit të lartë.

Brenda sistemeve e kornizave të tilla, titujt do të duhej të kishin rezultate të ndryshme, të përcaktuara qartë. Titujt nga cikli i parë dhe i dytë duhet të kenë orientime të ndryshme dhe profile të llojllojshme që i përshtaten shumëllojshmërisë së nevojave individuale, akademike si dhe tregut të punës. Diplomat e ciklit të parë duhet të lejojnë mundësi hyrjeje, në përputhje me Konventën e Lisbonës për njohjen e titujve, tek programet e ciklit të dytë. Diplomat e ciklit të dytë duhet të lejojnë mundësi hyrjeje në studimet e doktoratës.

Ministrat e ftojnë grupin pauses që të shqyrtojë mënyrat më të efektshme për lidhshmërinë e arsimit të lartë me ciklin e parë të një kornize të kualifikimeve brenda hapsirës evropiane të arsimit të lartë.

Ministrat e theksojnë përkushtimin që arsimit të lartë të jetë i hapur për të gjithë në mënyrë të njëjtë, në përputhje me aftësitë, duke pasur parasysh korrektësinë maksimale.

Promovimi i mobilitetit

Mobiliteti i studentëve dhe personelit akademik e administrativ është bazë për krijimin e një hapsire evropiane të arsimit të lartë. Ministrat e theksojnë rëndësinë e mobilitetit për shkaqe akademike e kulturore, ashtu si dhe për arsye politike, shoqërore dhe ekonomike. Ata vërejnë me kënaqësi se, që nga mbledhja e tyre e fundit, shifrat e mobilitetit janë rritur, në saje të përkrahjes thelbësore të programeve të Bashkësisë Evropiane, dhe pajtohen që t'i ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për ta përmirësuar cilësinë dhe sasinë e të dhënave statistikore për mobilitetin e studentëve.

Ata e ripohojnë vendimin për të bërë çdo përpjekje për zhdukjen e pengesave të mobilitetit brenda hapsirës evropiane të arsimit të lartë. Duke e pasur parasysh promovimin e mobilitetit të studentëve, ministrat do t'i ndërmarrin hapat e domosdoshëm për të mundësuar bartjen e kredive dhe granteve në vendet përkatëse.

Krijimi i një sistemi të kredive

Ministrat e theksojnë rolin e rëndësishëm të sistemit evropian për transferimin e kredive (ECTS) për mobilitetin e studentëve dhe për zhvillimin e kurrikulit ndërkombëtar. Ata theksojnë se ECTS-ja gjithnjë e më shumë po shndërrohet në një bazë sistemesh të kredive nëpër vendet përkatëse. Ata e nxisin përparimin e mëtejme me qëllim që ECTS-ja të jetë jo vetëm një sistem i transferimit, por edhe i akumulimit, që do të zbatohet me konsekuencë në hapsirën gjithnjë e më të zhvilluar të arsimit të lartë në Evropë.

Njohja e titujve: përvetsimi i një sistemi të titujve që lexohen dhe krahasohen lehtë

Ministrat e theksojnë rëndësinë e Konventës së Lisbonës për njohjen e titujve, që do të duhej të miratohet në të gjitha vendet pjesëmarrëse në procesin e Bolonjës, dhe kërkojnë nga rrjetet ENIC dhe NARIC që bashkë me autoritetet përgjegjëse kombëtare të përkujdesen për zbatimin e kësaj konvente.

Ata janë përcaktuar për një qëllim: të gjithë studentët që do të diplomojnë nga viti 2005 duhet ta marrin diplomën shtesë falas. Ajo duhet të jetë në një gjuhë të përhapur evropiane.

Ata kërkojnë nga institucionet dhe punëdhënësit që ta zbatojnë diplomën shtesë, ashtuqë të dalin në pah përparsitë e sistemeve transparente dhe fleksibile të titujve në arsimin e lartë. Kjo do ta

lehtësonte punësimin dhe njohjen akademike të titujve për përsosje të mëtejme.

Institucionet e arsimit të lartë dhe studentët

Ministrat e mirëpresin përfshirjen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të studentëve në procesin e Bolonjës, dhe e kanë të qartë se vetëm pjesëmarrja aktive e të gjithë partnerëve në këtë proces do ta sigurojë suksesin afatgjatë .

Të vetëdijshëm për kontributin që mund ta japin institucionet e fuqishme për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, ministrat pajtohen që këto institucione të kenë të drejtë të plotë për vendimmarrje lidhur me organizimin dhe administrimin e brendshëm. Ministrat poashtu kërkojnë nga institucionet që reformat të jenë plotësisht të përfshira në funksionet dhe proceset thelbësore të këtyre institucioneve.

Ministrat e theksojnë pjesëmarrjen konstruktive të organizatave të studentëve në procesin e Bolonjës dhe në veçanti nevojën e përfshirjes së vazhdueshme të studentëve në një fazë të hershme të aktiviteteve të mëtejme.

Studentët janë partnerë të barabartë në udhëheqjen e arsimit të lartë. Ministrat theksuan se po merren masa ligjore në të gjitha vendet ashtuqë të sigurohet pjesëmarrja e studentëve në hapsirën evropiane të arsimit të lartë. Ata poashtu kërkojnë nga institucionet dhe organizatat studentore që t'i identifikojnë mënyrat e rritjes së përfshirjes studentore në qeverisjen e arsimit të lartë.

Ministrat e theksojnë nevojën për krijimin e kushteve të duhura të studimit dhe jetës së studentëve, kështuqë ata të mund t'i përfundojnë me sukses studimet në një periudhë të përshtatshme kohore, pa pengesat që ndërliken me rrethanat e tyre shoqërore dhe ekonomike. Ata poashtu e theksojnë nevojën për të dhëna të krahasueshme për gjendjen shoqërore dhe ekonomike të studentëve.

Promovimi i dimenzionit evropian në arsimin e lartë

Ministrat theksojnë se, në vazhdimsi të takimit në Pragë, do të zhvillohen lëndë dhe planprograme të përmbajtjes, orientimit, dhe organizimit evropian.

Ata i nxorren në pah iniciativat e ndërmarra në institucionet e arsimit të lartë nëpër vendet evropiane që t'i shfrytëzojnë mundësitë akademike dhe traditat kulturore për promovimin e zhvillimit të programeve të integruara të studimit dhe diplomave të përbashkëta, në nivel të parë, të dytë, dhe të tretë.

Për më shumë, ata e theksojnë nevojën e sigurimit të një periudhe esenciale të studimit që do të duhej të kalohet jashtë, gjatë programeve të përbashkëta, si dhe dispozitat për diversitetin gjuhësor dhe për të nxënëit e gjuhës, ashtuqë studentët ta zhvillojnë maksimalisht identitetin, shtetësinë, dhe punësimin evropian.

Ministrat pajtohen që në nivel shtetëror të angazhohen për largimin e pengesave ligjore për themelimin dhe njohjen e diplomave të tilla dhe për përkrahjen e zhvillimit dhe sigurimit të cilësisë të planprogrameve të integruara ku merren diplomat e përbashkëta.

Promovimi i përparësive të hapsirës evropiane të arsimit të lartë

Ministrat pajtohen se duhet të nxirren në pah përparsitë dhe fuqia tërheqëse e hapsirës evropiane të arsimit të lartë. Ata zotohen për zhvillimin e programeve të bursave për studentët e vendeve të pazhvilluara.

Ministrat deklarojnë se shkëmbimet ndërkombëtare në arsimin e lartë duhet të mbështeten në cilësinë akademike dhe në vlerat akademike, dhe pajtohen që të punojnë maksimalisht në këtë drejtim. Sa herë që të jetë e mundur duhet të përfshihen partnerë të përshtatshëm shoqërorë dhe ekonomikë.

Ata e inkurajojnë bashkëpunimin me rajonin dhe me pjesët e tjera të botës nëpërmjet seminareve dhe konferencave për Bolonjën për përfaqësuesit e këtyre vendeve.

Të nxënëit gjatë gjithë jetës

Ministrat e theksojnë kontributin e rëndësishëm të arsimit të lartë për ta shndërruar të nxënëit gjatë gjithë jetës në realitet. Ata po përpiqen që t'i bashkërendojnë politikat e tyre vendore për përmbytjen e këtij qëllimi dhe i ftojnë institucionet e arsimit të lartë që t'i ofrojnë mundësitë për të nxënëit gjatë gjithë jetës në nivelin e arsimimit të lartë, duke e përfshirë këtu dhe njohjen e arsimimit të mëparshëm. Ata theksojnë se një veprim i këtillë duhet të jetë pjesë e pandarë e aktivitetit të arsimit të lartë.

Ministrat në vijim kërkojnë nga përgjegjësit për sistemin e kualifikimeve brenda hapsirës evropiane të arsimit të lartë që të përfshijnë një varg mundësish fleksibile të të nxënëit, mënyrash dhe teknikash të të nxënëit, që i shfrytëzojnë në mënyrë të duhur sistemin e kredive ECTS.

Ata e theksojnë nevojën për krijimin e mundësive për të gjithë qytetarët, në përputhje me synimet dhe mundësitë e tyre, që të ndjekin rrugën e të nxënëit gjatë gjithë jetës tek arsimi i lartë.

Veprimet plotësuese

Hapsira evropiane e arsimit të lartë dhe fusha e hulumtimit në Evropë – dy shtyllat e shoqërisë e cila mbështetet në njohuri

Të vetëdijshëm për nevojën e promovimit të ndërlidhjes mes EHEA-së dhe ERA-s në një Evropë të Diturive, dhe të vetëdijshëm për rëndësinë e hulumtimit si pjesë përbërëse të arsimit të lartë në Evropë, ministrat mendojnë se është e nevojshme që të tejkalohet përqëndrimi i tanishëm në dy ciklet kryesore të arsimit të lartë, duke e përfshirë nivelin e doktoratës si ciklin e tretë të procesit të Bolonjës. Ata e theksojnë rëndësinë e hulumtimit dhe trajnimit për hulumtim si dhe promovimin e dimenzionit ndërdisiplinar për zhvillimin e cilësisë të arsimit të lartë dhe nxitjen e konkurrimit në arsimin e lartë evropian përgjithsisht. Ministrat kërkojnë mobilitet të shtuar në nivelet e doktoratës dhe pas doktoratës, dhe i inkurajojnë institucionet përkatëse që ta shtojnë bashkëpunimin në studimet e doktoratës dhe në trajnimin e hulumtuesve të rinj.

Ministrat do t'i ndërmarrin të gjitha përpjekjet e nevojshme që t'i bëjnë institucionet evropiane të arsimit të lartë partnerë atraktivë dhe efikas. Prandaj, ministrat kërkojnë nga institucionet e arsimit të lartë që ta shquajnë rolin dhe rëndësinë e hulumtimit për evolucionin teknologjik, shoqëror dhe kulturor dhe për nevojat e shoqërisë.

Ministrat e kuptojnë se ekzistojnë pengesa për arritjen e këtyre qëllimeve të cilat nuk mynd të zgjidhen vetëm nga institucionet e arsimit të lartë. Andaj nevojitet një përkrahje e madhe, duke e përfshirë edhe atë financiare, si dhe nevojiten vendimet e duhura nga qeveritë vendore dhe organizmat evropianë.

Së fundi, ministrat theksojnë se rrjetimet në nivel të doktoratës duhen përkrahur ashtuqë të mund të nxitet zhvillimi i cilësisë së lartë dhe përsosjes që do të ishte një nga shenjat dalluese të hapsirës evropiane të arsimit të lartë.

Vlerësimi

Duke i pasur parasysh synimet e përcaktuara deri në vitin 2010, pritet që do të pëpillohen mjetet për vlerësimin e ecurisë dhe suksesit të arritur me procesin e Bolonjës. Një shqyrtim afatmesëm do të mund të ofronte të dhëna të duhura për përparimin aktual të këtij procesi dhe poashtu do të ofronte mundësi për përmirsimet eventuale, në përputhje me mundësitë.

Ministrat i japin detyrë Grupit mbështetës që të organizojë një proces vlerësimi të gatshëm për takimin e vitit 2005 dhe që për më tej të përgatisë raporte të hollësishme për zbatimin e prioriteteve të cilat përcaktohen për periudhën e ndërmjeme të dy viteve të ardhshme:

- Sigurimi i cilësisë
- Sistemi prej dy ciklesh
- Njohja e titujve dhe periudhave të studimit

Për më shumë, vendet pjesëmarrëse do të përgatiten që të mundësojnë përhapjen e të dhënave për hulumtim në arsimin e lartë në përputhje me synimet e procesit të Bolonjës. Ndërkaq, do të ndihmohet sigurimi i të dhënave për hulumtimet dhe rezultatet e hulumtimeve.

Veprimet e mëtejme

Anëtarët e rinj

Ministrat e konsiderojnë të nevojshme që ta përshtasin nenin e Komunikatës së Pragës për aplikimet për anëtarësi si vijon:

Vendet anëtare të Konventës kulturore evropiane do t'i plotësojnë kërkesat për anëtarësi në hapsirën evropiane të arsimit të lartë nëqoftëse ato deklarojnë se do të përcaktohen për synimet e procesit të Bolonjës dhe do t'i zbatojnë ato në sistemet e veta të arsimit të lartë. Aplikimet e këtyre vendeve duhet të përmbajnë të dhëna të mjaftueshme për zbatimin e parimeve dhe objektivave të deklaratës.

Ministrat vendosën që të pranojnë kërkesat për anëtarësi të Shqipërisë, Andorrës, Bosnjës dhe Hercegovinës, Selisë së Shenjtë, Rusisë, Serbisë dhe Malit të Zi, "ish republikës jugosllave të Maqedonisë" dhe t'i mirëpresin këto shtete si anëtarë të rinj që e zgjerojnë procesin në 40 vende evropiane.

Ministrat janë të vetëdijshëm se anëtarësia në procesin e Bolonjës nënkupton ndryshime dhe reforma thelbësore në të gjitha vendet që e kanë nënshkruar marrëveshjen. Ata pajtohen t'i përkrahin vendet nëshkruese gjatë këtyre ndryshimeve dhe reformave, duke i përfshirë ato në diskutimet e përbashkëta dhe në planet për përkrahje, që i përfshin procesi i Bolonjës.

Struktura në vazhdimsi

Ministrat ia besojnë zbatimin e të gjitha çështjeve të përmendura në Komunikatë, drejtimin e përgjithshëm të procesit të Bolonjës dhe përgatitjen e takimit të ardhshëm të ministrave, një Grupi mbështetës,

që do të përbëhet nga përfaqësues të të gjitha vendeve anëtare në procesin e Bolonjës dhe në Komisionin Evropian, bashkë me Këshillin Evropian, EUA-n, EURASHE-n, ESIB-in dhe UNESCO/CEPES-in si anëtar konsultues. Ky grup, që do të takohet të paktën dy herë në vit, do të udhëhiqet nga kryesia e BE, ndërkaq zavendës do të jetë vendi mikëpritës i konferencës së ardhshme të ministrave.

Kryesia e BE-së poashtu do ta mbikqyrë një Bord që do të përkujdeset për punën e Grupit mbështetës gjatë periudhës mes dy takimeve. Bordi do të përbëhet nga udhëheqësi, nga vendi i ardhshëm mikpritës në rolin e zavendësit, nga Kryesitë e mëparshme dhe të ardhshme të BE, nga tre vendet pjesëmarrëse që i ka zgjedhur Grupi mbështetës për një vit, nga Komisioni evropian dhe, në rolin e anëtarëve këshillëdhënës, Këshilli Evropian, EUA, EURASHE dhe ESIB. Grupi mbështetës ashtu si dhe Bordi mund të tubojnë grupe pune ad hoc ashtu siç e vlerësojnë të nevojshme.

Të tëra këto aktivitete do t'i përkrahë Sekretariati që do të themelohet në vendin mikpritës të Konferencës së ardhshme të ministrave.

Në takimin e parë pas Konferencës së Berlinit, Grupi mbështetës e ka për detyrë që t'i përcaktojë përgjegjësitë e Bordit dhe detyrat e Sekretariatit.

Programi i punës 2003-2005

Ministrat kërkojnë nga Grupi mbështetës që t'i koordinojë aktivitetet për ecurinë e procesit të Bolonjës në përputhje me temat dhe veprimet e theksuara në Komunikatë dhe të raportojë lidhur me to në takimin e ardhshëm të ministrave në 2005.

Konferenca e ardhshme

Ministrat pajtohen që ta mbajnë konferencën e ardhshme në qytetin Bergen (Norvegji) në maj të vitit 2005.

Perkthimi u mundësua nga SEE ECN